

PARANDALIMI DHE BALLAFAQIMI ME RADIKALIZIMIN QË MUND TË ÇOJË NË
EKSTREMIZËM TË DHUNSHËM

**DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT NË SHKOLLAT E MESME DHE
VEGLA PËR ZBULIM TË HERSHËM DHE VEPRIM**

Identifiko, Parandalo, Vepro

Autorët e doracakut:

Mr. Afrodita Musliu

Dr. Ivica Simonovski





*„ARSIMI ËSHTË ARMÄ MË E FUQJSHME TË CILËN MUND TA
PËRDORNI PËR TA NDRYSHUAR BOTËN“.*

- Nelson Mandela

IMPRESUM

Titulli: *DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT NË SHKOLLAT E MESME DHE VEGLA PËR ZBULIM TË HERSHËM DHE VEPRIM*

Autorët: *Mr. Afrodita Musliu dhe Dr. Ivica Simonovski*

Botues: *Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave*

Kursi i gjuhës shqipe: *Sheriban Kllokoçi*

Vula dhe dizajni: *Sito Grafika*

Numri i kopjeve: *150*

Viti: *2019*

Ky Doracak u zhvillua në kuadër të projektit “Eduko për të parandaluar - Përforcimi i stafit mësimdhënës dhe prindërve për ndërtimin e rezistencës tek të rinjtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, të zbatuar nga Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave - QHKP dhe Qendra për Zhvillimin e Arsimit - CED në bashkëpunim me konceptin civil NEXUS. Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Qendrës Hedaja për përsosmëri për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si pjesë e Programit global STRIVE, nëpërmjet Instrumentit për Kontribut për Stabilitetin dhe Paqen e Bashkimit Evropian.



Project
funded by the
EUROPEAN UNION

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë Doracak i pasqyrojnë mendimet dhe qëndrimet e autorëve të këtij publikimi dhe nuk paraqesin mendimet e Bashkimit Evropian apo një organizate tjetër mbështetëse.

Parathënie

Duke ndjekur praktikat¹ ndërkombëtare dhe rajonale në kundërshtimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm, si sfida prioritare të sigurisë së kohës së sotme dhe në drejtim të procesit parandalues, është përgatitur një Doracak për parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm për stafin mësimdhënës të shkollave të mesme në Maqedoni (Identifiko, Parandalo, Vepro).

Doracaku e thekson rëndësinë e vlerave dhe parimeve arsimore në kundërshtimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Qasja holistike (gjithëpërfshirëse) dhe pragmatike në sistemin e arsimit mund të kontribuojë për promovimin e tolerancës dhe zhvillimin e mekanizmave për “identifi-

¹ UNESCO (2016), Doracak për mësimdhënësit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, [hp://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf).

kimin e hershëm” të dukurive dhe ideologjive të cilat promovojnë ekstremizmin e dhunshëm.

Doracaku është në përputhje me prioritetet themelore të Strategjisë së Republikës së Maqedonisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm për periudhën 2018-2022² dhe **objektivat strategjike:** (1) përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve institucionale për identifikimin dhe shënimin e individëve, grupeve dhe faktorëve të tjerë me efekt radikalizues ndaj rrethinës së tyre, dhe (2) përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve institucionale për zvogëlimin e efekteve të iniciatorëve të radikalizmit që çojnë në **ekstremizëm të dhunshëm dhe në fund në aktivitete terroriste.**

² Strategjia kombëtare e RM-së për ballafaqimin e ekstremizmit të dhunshëm 2018-2022. faqja 34. http://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/sne_nacionalna_strategjia_2018.pdf

Vegla themelore metodologjike për përgatitjen e Doracakut është analiza e praktikave pozitive ndërkombëtare në kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, të miratuara në vendet e tjera dhe të përshtatura dhe të integruara në kontekstin arsimor të Republikës së Maqedonisë. Ky doracak është pjesë e aktiviteteve të projektit

“Eduko për të parandaluar”, në kuadër të të cilave për shkak të sigurimit të relevancës në kontekste të ndryshme gjeografike dhe socio-kulturore, paraprakisht u realizua një proces hulumtues në disa shkolla të mesme në Shkup, Kumanovë, Tetovë dhe Gostivar, në bazë të të cilit është përgatitur edhe një studim bazë.

Hyrje

Kërcënimi nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çon në dhunë janë sfida dhe fenomene me një dimension ndërkombëtar, nga të cilat nuk është përjashtuar as rajoni i Ballkanit Perëndimor, duke e përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë. Duke shikuar nëpër prizmin e iniciatorëve fetarë për zhvillimin e ekstremizmit dhe radikalizmit, është fakt se virusi i quajtur “luftëtarë të huaj terroristë” nuk e anashkaloi as Republikën e Maqedonisë. Një konfirmim për këtë është numri i madh i luftëtarëve të huaj që shkuan dhe u kthyen në/nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak në vitet e fundit, kryesisht popullatë e re, e indoktrinuara dhe e radikalizuara nën ndikimin e faktorëve dhe arsyeve të ndryshme. Është shumë e rëndësishme të theksohet edhe ekstremizmi politik i cili mund të jetë ekstrem i djathtë dhe ekstrem i majtë. Edhe pse ka dallime mes tyre, e djathta ekstreme dhe e majta ekstreme janë mjaft të lidhura për shkak të karakteristikave që vijojnë: mohimi i demokracisë dhe mjeteve të saja për tolerancë, parlamentarizmi dhe legalizimi dhe ajo që është më e rrezikshme - përdorimi i dhunës si një metodë e

veprimit. Derisa socializmi, anarkizmi, ekologjizmi dhe feminizmi përfaqësojnë bazën ideologjike të cilën e përcakton e majta ekstreme, fashizmi, nacionalizmi, fundamentalizmi dhe konservatizmi religjioz mund të jenë baza ideologjike nga e cila zhvillohet e djathta ekstreme. Në mënyrën e realizimit të qëllimeve të tyre mund të zbatojnë metodat e dhunës, madje edhe aktet e terrorizmit. Këto fenomene globale mund ta minojnë stabilitetin e çdo vendi, veçanërisht të atyre multinacionale, me polarizime dhe ndarje të përkohshme, më së shpeshti në planin ndëretnik dhe fetar, i cili është specifik për nënqiellin tonë. Në këto shoqëri multikulturore dhe multietnike, siç është Maqedonia, mund të ndodhë një rritje të distancës etnike përmes etno-nacionalizmit dhe religjionit, duke shkaktuar një bashkëjetesë komplekse që mund të çojë në paraqitje të qëndrimeve radikale të disa grupeve apo individëve.

Manifestimi i këtyre fenomeneve nuk njih diskriminimin e cilësdo bazë, por përvojat tregojnë se popullata e re, si më e rrezikuar, mund të jetë një grup i lehtë

“qëllimor”, i cili bie nën ndikimin e mesazheve të ekstremistëve të dhunshëm dhe organizatave terroriste. Prandaj, arsimi formal si një institucion social ka rol kyç në ndikimin dhe zhvillimin e veçorive, vlerave dhe mundësive pozitive për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në mesin e të rinjve, të cilat do t’i ndihmojnë ata të ndërtojnë rezistencë ndaj propagandës ekstremiste.

Përgatitja e Doracakut “Identifiko, Parandalo, Vepro” ka për qëllim që ta nxisë stafin mësimdhënës për t’i

kuptuar dhe për t’i identifikuar fenomenet e lartpërmendura globale, duke e zvogëluar ose minimizuar pasojat e dëmshme të të njëjtave.

Doracaku ofron mbështetje dhe udhëzim për stafin mësimdhënës në shkollat e mesme për identifikimin e shenjave të hershme të sjelljes ekstreme dhe radikalizmit të nxënësit, duke treguar këshilla dhe opsione të dobishme praktike për t’iu përgjigjur sfidave dhe situatave konkrete në mënyrë adekuate dhe pedagogjike.



„ Askush nuk lind me urrejtje ndaj një personi tjetër vetëm për shkak se ai person ka ngjyrë tjetër të lëkurës, prejardhje të ndryshme ose religjion të ndryshëm. Njerëzit mësojnë se si të urrejnë, ata mund të mësohen edhe se si të duan, dashuria është më e natyrshme për zemrën e njeriut sesa e kundërta “

- Nelson Mandela

Metodologjia

Doracaku për mësimdhënësit e shkollave të mesme dhe veglat për zbulim dhe trajtim të hershëm është përgatitur nga një ekip i përbërë nga dy ekspertë profesionalë për parandalim dhe trajtim të ekstremizmit të dhunshëm dhe është miratuar nga donatori i projektit, Qendra për përsosmëri Hedaja nga Abu Dabi, Emiratet Arabe dhe nga Byroja për zhvillimin e arsimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përgatitja e doracakut është në kuadër të projektit **“Eduko për të parandaluar - Përforcimi i stafit mësimdhënës dhe prindërve për ndërtimin e rezistencës tek të rinjtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”**. Atë e realizon Qendra për Hulimtim dhe Krijim të Politikave nga Shkupi në partneritet me Qendrën për Zhvillimin e Arsimit nga Tearca dhe Shoqatën e qytetarëve NEKSUS - Koncept civil nga Shkupi.

Qëllimi kryesor i projektit është që të zhvillohet rezistencë te bashkësia ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Qëllimet specifike të projektit

janë: 1) Ta nxisë stafin mësimdhënës dhe prindërit e nxënësve që t'i identifikojnë shenjat e hershme të radikalizimit; 2) Të ngrihet vetëdija në shkollat për rreziqet e internetit dhe përdorimin e arsimit për t'u rritur rezistenca ndaj propagandës ekstremiste dhe rekrutimit; 3) Përforcimi i kapaciteteve të komunave për vendosje të një sistemi të paralajmërimit të hershëm për radikalizim.

Me realizimin e këtyre qëllimeve priten këto rezultate: 1) Kapacitete të ngritura të stafit mësimdhënës dhe prindërve për nevojën e identifikimit të shenjave të hershme të radikalizimit; 2) Përforcimi i stafit mësimdhënës dhe rezistencës te nxënësit ndaj propagandës ekstremiste dhe rekrutimit; 3) Sistem i zhvilluar për ekstremizmin e dhunshëm parandalues për nevojat e komunave për zbulim të hershëm të radikalizimit.

Në kuadër të projektit, janë paraparë këto aktivitete:

- ✓ Përgatitja e studimit bazik dhe analizës;

- ✓ Zhvillimi i vlerësimit për nevojat e stafit mësimdhënës;
- ✓ Përgatitja e doracakut dhe veglave për zbulimin e hershëm të shenjave të radikalizimit;
- ✓ Ngritja e kapaciteteve (programe për trajnim, trajnim) të stafit mësimdhënës, prindërve dhe nëpunësve komunalë;
- ✓ Zhvillimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe ridrejtimi i problemeve të identifikua (sisteme referente) në nivel komunal;

Në bazë të konkluzioneve të studimit bazik të perceptimeve të mësimdhënësve, pedagogëve dhe psikologëve për fenomenin e radikalizimit i cili mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, të zbatuar në periudhën maj – qershor të vitit 2018, duke përfshirë 505 mësimdhënës nga 22 shkolla të mesme në rajonin e Shkupit, Kumanovës, Tetovës dhe Gostivarit, u paraqit nevoja për përgatitjen e këtij Doracaku për mësimdhënësit e shkollave të mesme, i cili do të mundësojë identifikim më të lehtë dhe më të shpejtë të shenjave të hershme të radikalizimit të nxënësit. Njëkohësisht, Doracaku ofron vegla për veprim të duhur me qëllim që të parandalohet procesi i radikalizimit, i cili mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm.

Doracaku në përmbajtjen e tij definon qëllimet specifike të cilat duhet të plotësohen: 1) Ngritja e vetëdijes të stafi mësimdhënës për rreziqet e radikalizimit; 2) Njohja e rreziqeve dhe faktorëve të cilët do të mund t'i bëjnë të rinjtë të prirur ndaj radikalizimit që çon në dhunë; 3) Ofrimi i veglave për stafin mësimdhënës për identifikim të shenjave të hershme të radikalizimit që çon në dhunë dhe qëllime të tjera të parapara me Doracakun.

Doracaku definon nocionet themelore me të cilat duhet të njihet stafi mësimdhënës gjatë vlerësimit dhe identifikimit të shenjave të hershme të radikalizimit të nxënësit. Në korrelacion me studimin bazik dhe analizën, janë përcaktuar faktorët e radikalizimit të cilët mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.

Varësisht nga ndarja e fazave të ndryshimeve në sjelljen e nxënësve, si: sjellje problematike, sjellje shqetësuese dhe sjellje alarmante, Doracaku ofron një set indikatorësh të cilat t'i mundësojnë stafit mësimdhënës që t'i identifikojë më lehtë ndryshimet e sjelljes së nxënësve dhe t'i identifikojë në mënyrë përkatëse me secilën e fazave. Indikatorët që prezantohen në këtë Doracakmund të merren parasysh si shenja të mundshme të një procesi të radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm nëse individit manifeston kombinim të disa indikatorëve në të njëjtën kohë ose në periudhë të caktuar të vazhdueshme. Po ashtu,

këta indikatorë nuk duhet ta zëvendësojnë vlerësimin e tërësishme të procesit të identifikimit të një individi të radikalizuar dhe nuk duhet të merren parasysh si burim i vetëm, sipas të cilit do të merren konkluzione.

Duke ndërmarrë rolin e dominuslitis-it, mësimdhënësi duhet të nisë iniciativë të vet për përjashtimin e dukurive të këtilla. Krahas drejtimeve standarde mësimore, mësimdhënësit duhet të krijojnë kushte të volitshme dhe mjedis të sigurt edhe për diskutime të hapura për çështje të lidhura me politikat aktuale qeveritare, çështje të ndryshme kontroverse dhe tema si radikalizmi që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Doracak u ofron një set Protokollesh për veprim gjatë identifikimit të sjelljes së ndryshme të nxënësit për secilën fazë veç e veç dhe shembuj me këshilla se si mësimdhënësit di të duhej të vepronin nëse në situata të caktuara në klasë dhe në shkollë ndodhin gjëra të cilat mund të çojnë në konflikte dhe dhunë midis individëve ose një grupi të caktuar të nxënësve.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij doracakut është që të ngrihet vetëdija e stafit arsimor dhe institucioneve që punojnë në këtë fushë, të ndihmojnë bashkësinë dhe të

ndërtojnë një kapacitet institucional për zgjidhjen më të mirë të sfidave me të cilat ballafaqohen. Më konkretisht, të ngrihet vetëdija e stafi arsimor dhe prindërit për rreziqet e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, përmes mundësimin të njohurive dhe resurseve, që të ndihmojnë nxënësit të mbrohen nga këto rreziqe. Ky doracak është në përputhje me “Strategjinë kombëtare të RM-së për ballafaqim me ekstremizmin e dhunshëm 2018-2022”, e cila e thekson nevojën e gatishmërisë dhe rezistencës në nivel lokal dhe kombëtar nëpërmjet paralajmërimit të hershëm me përfshirjen e stafit arsimor në identifikimin e hershëm të radikalizmit të nxënësit dhe ky doracak ofron mënyra për t’i shërbyer këtij qëllimi.

Programet, iniciativat dhe aktivitetet edukative për parandalim dhe ballafaqim me radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm duhet ta mbështesin, ta ruajnë dhe ta zhvillojnë drejtësinë sociale, interkulturalizmin dhe respektimin e të drejtave universale të njeriut.

Qëllimet specifike të doracakut

- ✓ Ngritja e vetëdijes së stafit mësimdhënës për rreziqet e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm;

- ✓ Njohja me rreziqet dhe faktorët të cilët do të mund t'i bënin të rinjtë t'i nënshtrohen radikalizmit që çon në dhunë;
- ✓ Nxitja për zhvillimin e praktikës te mësimdhënësit që të stimulojnë një debat dhe diskutim për temat e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit; të promovojnë tolerancë, kohezion të bashkësisë dhe vlera të përbashkëta në shoqëri, me qëllim që të krijohet një klimë pozitive për bisedë të hapur dhe mendim kritik;
- ✓ Ofrimi i një vegle për stafin mësimdhënës për identifikimin e shenjave të hershme të radikalizmit që çon në dhunë;
- ✓ Prezantimi i skenarëve të supozuar me të cilët mund të ballafaqohet stafi mësimdhënës dhe opsionet për ndërmarrjen e aksioneve për të vepruar lidhur me një rast konkret;
- ✓ Tejkalmi (thyerja) i perceptimit të gabuar dhe miteve të ekstremizmit të dhunshëm me kuptimin e qasjes “Mos bëj dëme”;
- ✓ Kuptimi i dallimeve midis qasjes së fortë dhe të butë dhe rëndësia e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Grupi qëllimor

- ✓ Stafi mësimdhënës në shkollat
- ✓ Stafi tjetër edukativ dhe pedagogjik për mbështetje në shkollat (psikologët, sociologët, defektologët etj.)
- ✓ Këshilli i prindërve.



Nocionet, definicionet dhe shkaqet për radikalizmin që çon në dhunë

Nuk ka definicione konsistente dhe përgjithësisht të pranuar për ekstremizmin, ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe radikalizmin që çon në dhunë. Më poshtë janë dhënë definicionet e pranuar nga UNESCO-ja³ dhe nga autorë⁴, të tjerë relevantë dhe të njëjtat janë me qëllim që t'i mundësohet stafit mësimdhënës t'i kuptojë më lehtë nocionet dhe proceset e radikalizmit që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.

³ UNESCO (2016), A Teacher's Guide on the Prevention of Violent Extremism <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf>

⁴ Schmid, Radicalisation, De-Radicalisation and Counter-Radicalisation, 26. <https://www.icct.nl/download/file/ICCT-Schmid-Radicalisation-De-Radicalisation-Counter-Radicalisation-March-2013.pdf>

Ekstremizmi

Besimi dhe përkrahja e ideve që janë shumë larg asaj që shumica e njerëzve mendojnë se është korrekte dhe e arsyeshme. Për këtë shkak "ekstremizmi" ka të bëjë me qëndrimet ose sjelljen për të cilën mendohet se është jashtë normave.

Ekstremizmi i dhunshëm

Ekstremizmi i dhunshëm ka të bëjë me besimet dhe veprimet e personave të cilët mbështesin ose përdorin dhunën për t'i realizuar qëllimet ideologjike, fetare ose politike.

Radikalizimi

Radikalizimi është proces përmes të cilit individ/grupi i pranon qëndrimet ekstreme, politike ose religjioze, përkatësisht ideologjinë përmes së cilës tentohet të kryhet një ndryshim i rëndësishëm në shoqëri.

Radikalizimi që çon në ekstremizëm të dhunshëm

Procesi përmes të cilit individ ose grupi mendon ta përdorë dhunën si mjet legjitim ose i dëshirueshëm për të vepruar me qëllim që të kryhet një ndryshim i rëndësishëm në shoqëri.

<p>Indoktrinimi</p>	<p><i>Miratimi i një doktrine të caktuar (besime), tendenca e ndonjë force të organizuar për të imponuar kuptime, besime dhe mënyra të caktuara të sjelljes.</i></p>	<p>Faktorët e shtytjes (push factors)</p>	<p><i>Faktorë të shtytjes janë karakteristikat negative, sociale, kulturore dhe politike të rrethinës shoqërore të dikujt, të cilat ndihmojnë “shtytjen” e individëve të rrezikuar në rrugën e ekstremizmit të dhunshëm.</i></p>
<p>Terrorizmi</p>	<p><i>Procesi i sjelljes së dhunshme të individëve dhe grupeve që është rezultat i motiveve politike ose ideologjike, të drejtuar për shkatërrim, dëmtim dhe frikësim të njerëzve dhe infrastrukturës kritike me pasoja të konsiderueshme negative.</i></p>	<p>Faktorët e tërheqjes (pull factors)</p>	<p><i>Faktorët e tërheqjes janë ata të cilët tregojnë “karakteristikat dhe përfitimet pozitive” të organizatës (së dhunshme) ekstremiste, e cila “tërheq” individët e rrezikuar që të përfshihen.</i></p>

Arsyet – faktorët e radikalizmit që çon në dhunë


Ka arsye dhe faktorë të ndryshëm për nxitjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në dhunë dhe nuk ekziston një indikator i vetëm që sigurisht zbulon se një person është i rrezikuar. Tradicionalisht, iniciatorët e ekstremizmit të dhunshëm ndahen në dy kategori: Faktorë të shtytjes (Push factors) dhe faktorë të tërheqjes (Pull factors), të cilët duhet të perceptohen dhe zgjidhen në kontekstin e parandalimit. Kuptimi i këtyre faktorëve është i rëndësishëm me qëllim që të shmanget gjeneralizimi i cili mund të shkaktojë etiketimin e të gjithë popullatës, të krijojë një ndjenjë të pakënaqësisë kolektive ose të stimulojë në mënyrë shtesë qëndrime të dhunshme ekstremiste.

Faktorët e shtytjes (Push Factors) përfshijnë: ankesat sociale, politike dhe ekonomike; ndjenjën e padrejtësisë dhe diskriminimit; krizën personale dhe tragjeditë; frustrimin; tjetërsimin; fascinimin me dhunë; kërkimin e përgjigjeve të kuptimit të jetës;

kureshtjen; krizën e identitetit; përjashtimin social; marginalizimin; mohimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve; narrativët historikë; dëshpërimin nga proceset demokratike; polarizimin etj.

Faktorët e tërheqjes (Pull Factors) përfshijnë: kërkimin personal, ndjenjën e përkatësisë ndaj grupeve të caktuara që mundësojnë dobi të ndryshme gjatë anëtarësisë ose pjesëmarrjes në to: punësim, para ose dobi tjetër materiale, premtimin e idealeve më të mëdha krahas atyre materiale – liria, aventura, rehatia shpirtërore, ideologjinë ose rrjetin social; fuqinë dhe kontrollin; ndjenjën e lojalitetit dhe përkushtimit; ndjenjën e eksitimit dhe aventurës; shikimin e romantizuar ndaj ideologjisë dhe shkakut; mundësinë për heroizëm, shpengimin personal, shtrembërimin dhe keqpërdorimin e besimeve, ideologjive politike dhe dallimet etnike dhe kulturore (tërheqja e qëndrimeve të thjeshta botërore që ndajnë botën në “ne kundër tyre”) etj.

Në esencë, procesi i radikalizmit të popullata e re mund të ketë disa faktorë: përjetimi i privimit relativ, faktorë të lidhur me identitetin, siç janë diskriminimi, përfshirja dhe integrimi, pasiguria dhe kërcënimi i



Ilustrimi 1.
 Faktorët e
 tërheqjes dhe
 shtytjes

perceptuar fizik ose simbolik. Këta faktorë themelorë në një shkallë të caktuar janë të rëndësishëm për grupe të ndryshme radikale. Ata përbëjnë kushtet psikologjike dhe strukturore që nxisin procesin e radikalizimit. Edhe pse këta faktorë themelorë çojnë drejt një frustrimi personal, ata gjithmonë nuk e bëjnë individin të rrezikuar deri në atë shkallë që të radikalizohet dhe të ndërmarrë akte të dhunës. Që të mund të ndodhë e kundërta, është e nevojshme të bëhet një analizë më e thellë.

Faktorët strukturalë të cilët veprojnë si arsye për rritjen e përshtatshmërisë për zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm janë gjithashtu të rëndësishëm: rregullimi i dobët i shtetit, mungesa e sundimit të ligjit, korrupsioni dhe krimi, sidomos kur kombinohen me disa elemente të tjera. Këta faktorë janë kompleks, të shumëfishtë, të ndërlikuar njëri me tjetrin dhe të lidhur ngushtë me elementet strukturore të mjedisit jetësor që mund të nxisin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Më së shpeshti bëhet fjalë për një kombinim të faktorëve të përmendur, por edukimi, posedimi i informacioneve dhe njohja e shkaqeve të radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm mund të jenë hapat e parë në kundërshtimin e këtij fenomeni.



Ilustrimi 2 Faktorët (shoqërorë) strukturorë që nxisin radikalizimin

Këta faktorë nuk duhet të shqyrtohen në mënyrë individuale dhe të ndarë. Në bashkëveprim duhet të merren parasysh edhe faktorët individualë (Tjetërsimi dhe përjashtimi, zemërimi dhe frustrimi, dobësitë personale, kërkimi i identitetit dhe dinjitetit personal, hakmarrja për shkak të traumave të përjetuara paraprake, nënvlerësimet, mosrespektimi dhe keqpërdorimi etj.), të cilat kontribuojnë për radikalizimin e personave.

Roli i arsimit dhe stafit mësimdhënës në parandalimin e radikalizmit që çon në dhunë

ROLI I ARSIMIT

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë një temë komplekse. Për këto arsye, është e vështirë të gjendet një formulë për zgjidhjen e tyre. Ngritja e vetëdijes te mësimdhënësit duhet të çojë në identifikimin e shenjave të hershme të sjelljes devijuese dhe të pazakonshme të nxënësve, ndjekjen e gjendjeve me qëllim që ata të mos ndërmarrin aktivitete të dhunshme dhe ekstremiste, si dhe ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve adekuate me qëllim që t'i pengojnë ata. Parandalimi i radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm kërkon një bashkëpunim të përforcuar ndërmjet nxënësve, mësimdhënësve, udhëheqësisë së shkollës dhe prindërve. Për këtë arsye, nevoja për përfshirjen e arsimit është e pashmangshme, si

mënyra e parë dhe më efektive e parandalimit dhe kundërshtimit, përkatësisht metoda më e mirë dhe jo e dhunshme që nxit ndryshime. **Arsimi ofron masa proaktive të cilat janë relativisht të lira në luftën kundër zhvillimit të pikëpamjeve ekstremiste dhe është e nevojshme t'u kushtohet më shumë vëmendje shkollave për parandalimin dhe kundërshtimin e këtyre fenomeneve.**

Në Republikën e Maqedonisë, ky problem nuk e merr vëmendjen e duhur dhe theksohet nevoja e përpjekjeve të vazhdueshme për avancimet potenciale të stafit mësimdhënës, si dhe për pozicionim institucional.

Arsimi vetë nuk mund t'i parandalojë individët t'i kycen ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, por mund të parandalojë ruajtjen e një mjedisi të

favorshëm për zhvillimin e këtyre fenomeneve. Që të arrihet kjo, shkollat duhet:

- ✓ të jenë hapësira të sigurta ku nxënësit do të mund të debatojnë dhe të bisedojnë haptas për çështje të ndjeshme, politike, religjioze dhe të tjera;
- ✓ të sigurojnë përfshirjen dhe barazinë në arsim, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut, pa e marrë parasysh përkatësinë etnike, religionin ose nacionalitetin.

Në përgjithësi, arsimi (formal dhe joformal) ka potencial përmes përdorimit të masave të buta t'i ndihmojë të rinjtë në drejtim të:

- ✓ zhvillimit të rezistencës ndaj narrativëve ekstremistë, si dhe fitimit të aftësive sociale emocionale që mund t'i ndihmojnë të rinjtë ta analizojnë në mënyrë kritike përmbajtjen e narrativëve, të jenë të hapur ndaj llojllojshmërisë dhe të kontribuojnë në mënyrë konstruktive ndaj shoqërisë, pa përdorur dhunën (përmes aftësive, mendimit kritik dhe edukimit mediatik)
- ✓ zhvillimit të aftësive komunikuese dhe ndërpersonale të nevojshme për dialog dhe

gjetjen e një kompromisi për qasje të qetë ndaj ndryshimeve;

- ✓ nxitjes dhe promovimit të aftësive për mendim kritik;
- ✓ promovimit të tolerancës dhe respektimit, në bazë të paqes dhe dialogut;
- ✓ edukimit mediatik me të cilën gjë do të sigurohej se të rinjtë do të mundën në mënyrë efikase të procedojnë, filtrojnë dhe analizojnë sasi të mëdha të informacioneve që janë në dispozicion në internet;
- ✓ ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit të përbashkët të qytetarëve;
- ✓ punës aktive dhe krijimit të programeve edukative të cilat do të kontribuojnë për të kuptuar ekstremizmin dhe radikalizmin si forma të padëshiruara dhe negative të sjelljes.

Aftësia të ndërmerren masa proaktive që të parandalohet radikalizimi i të rinjve gjendet në institucionet qendrore dhe lokale qeveritare, institucionet e sigurisë, bashkësitë fetare, si dhe shkollat që kërkojnë mënyra më të mira për ta luftuar radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm tek të rinjtë. Qëllimi i fundit duhet të jetë përforcimi i rezistencës ndaj kësaj

çështjeje në kuadër të sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë.

ROLI I STAFIT MËSIMDHËNËS

Roli i mësimitdhënësve në këtë pjesë parandaluese është kryesisht në fokusin e sigurisë së fëmijëve dhe të rinjve. Mësimitdhënësit dhe stafi tjetër shkollor janë në një pozicion kyç për t'i mbrojtur nxënësit nga radikalizmi dhe ndikimet ekstremiste pavarësisht rolit që kanë ata në mbrojtjen e nxënësve të tyre në kuptim të përgjithshëm (keqtrajtimi, përdorimi i drogave, eksploatimi seksual etj.). Roli i tyre është kryesisht arsimor, e jo mbikëqyrës. Për shkak se mësimitdhënësit janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të rinjtë, lirisht mund të thuhet se ata janë një model për ndryshime, si dhe ndërmjetësues të cilët promovojnë dialogun dhe nxisin respektin e ndërsjellë. Pastaj, mësimitdhënësi derisa është në klasë e ka rolin e lehtësuesit (fasilitatorit), duke mbështetur nxënësit derisa mësojnë t'i vlerësojnë provat, të negociojnë, të marrin vendime të informuara, të zgjidhin problemet dhe të punojnë, si në mënyrë të pavarur ashtu edhe me të tjerët.

Të drejtuar drejt qëllimeve të tyre, nxënësit shpeshherë mund ta ndryshojnë sjelljen e tyre duke ndërmarrë aktivitete që nuk kanë qenë karakteristike për ta në periudhën e kaluar.

Në rrethana të tilla, mësimitdhënësi ka rolin dominues (*dominuslitis*) në klasë dhe mjedisin shkollor. Duke i njohur nxënësit, ai duhet të identifikojë çdo sjellje të tyre devijuese, të pazakonshme dhe të pazakontë. Ai duhet të ndjekë situatën, duke hetuar arsyet për paraqitjen e tyre. Në bazë të kësaj, mësimitdhënësi duhet të ndërmarrë aktivitete të cilat do të kontribuojnë për ndërtimin e një kulture jo të dhunshme shkollore midis nxënësve, duke i penguar ata që t'i përdorin aktet e dhunës. Ndërmarrja e aktiviteteve nga ana e mësimitdhënësit, si dhe lloji i aktiviteteve nuk duhet të shkaktojnë një efekt të kundërt. Për këtë qëllim, gjithsesi se është e nevojshme vetëdija e lartë e mësimitdhënësve. Gjithsesi se mësimitdhënësit nuk mund vetë ta parandalojnë dhunën, ekstremizmin dhe radikalizmin në shkollë, por e gjithë bashkësia e shkollës duhet të bashkohet për të arritur një marrëveshje për marrjen e një mesazhi të fortë dhe të qartë se këto dukuri janë të papranueshme në shkollë.

Procesi i radikalizimit te popullata e re

Radikalizmi tek të rinjtë zakonisht ndodh gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Por, në disa raste ai mund të ndodhë edhe shumë më shpejtë, si rezultat i një incidenti të caktuar ose një lajmi të keq. Shenjat e radikalizimit nganjëherë manifestohen tek të rinjtë në mënyrë shumë të qartë dhe paralajmëruese, por ka edhe raste kur ndryshimet të cilat ndodhin te fëmijët si rezultat i procesit, janë shumë pak të dukshme, e madje mund të jenë të padukshme. Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se edhe kryerja e akteve konkrete të dhunës mund të ndodh shumë shpejtë, përkatësisht për disa ditë.

Vitet e adoleshencës janë periudha e ndryshimeve të mëdha dhe të rinjtë shpeshherë kanë nevojë të jenë të vetëm, zemërohen lehtë dhe shpejtë dhe më së shpeshti nuk janë të hapur për bisedim, sidomos kur kanë probleme. Manifestimet e këtilla të përziera

në masë të madhe e vështirësojnë diferencimin midis sjelljes normale të adoleshentëve dhe ndryshimeve të sjelljeve që tregojnë se ndoshta fëmija është ekspozuar ndaj ndikimeve radikale.

Popullata e re konsiderohet si një nga grupet më të rrezikuara të personave të cilët bien lehtë nën ndikimin e grupeve të caktuara radikale të cilat praktikojnë dhunën dhe ekstremizmin. Dëshira për të qenë pjesë e një grupi të caktuar, kërkimi i identitetit, dëshpërimi nga institucionet, statusi social dhe familjar, kërkimi i argëtimit dhe aventurës është ajo që i bën të rinjtë shumë të rrezikuar që të bien nën ndikime të ndryshme dhe të pranojnë madje edhe aktivitete të dhunshme me qëllim që t'i plotësojnë pritjet dhe idealet e tyre. Më së shpeshti, manipulimi i të rinjve është në një bazë individuale emocionale, ku personat e ashtuquajtur rekrutues i zgjedhin të

rinjtë të cilët për momentin kanë ndonjë brengosje për ndonjë gjë të humbur, marrëdhënie të keqe ose mospajttime me prindërit dhe në shkollë, kanë një ndjenjë se nuk janë të dashur nga të dyja anët, nuk

kanë mjaftë financa, nuk kanë shoqëri, kanë ndjenjën se nuk i takojnë komunitetit, ndjenjën e shpresës së humbur se ka një ardhmëri për ta, ndjenjën e një padrejtësie personale etj.

Indikatorët e identifikimit të hershëm të shenjave të radikalizmit

Mësimdhënësit luajnë një rol kyç në parandalimin e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Është e rëndësishme të mbahet mend se nuk ka indikator apo një sërë indikatorësh të paraparë që mund të përcaktojnë nëse individit është radikalizuar. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se pa dallim përkatësisë kulturore ose religjioze, cilido individ ose nxënës mund të bjerë në procesin e radikalizmit që çon në dhunë.

Fazat e prezantuara më poshtë janë vetëm një sërë indikatorësh që i bëjnë të rinjtë të rrezikuar nga radikalizmi dhe të njëjtat janë prezantuar në një kontekst lokal. Është shumë e rëndësishme që mësimdhënësit t'i identifikojnë me kohë dhe saktë shenjat e hershme që i bëjnë nxënësit të rrezikuar nga radikalizmi që çon në dhunë, me qëllim që të mund të reagojnë me kohë dhe ta pengojnë procesin e mëtejshëm të radikalizmit. Fazat ndahen në tri kategori në bazë të shkallës së ndryshimeve në sjelljen e nxënësve gjatë periudhës shkollore. Shenjat e identifikimit të radikalizmit

që çon në dhunë, të shkruara më poshtë, duhet të merren vetëm si një udhërrëfyes, ato nuk janë një vlerësim i përgjithshëm i shkallës së radikalizimit të individit. Këshilli për mësimdhënësit është që ata të mendojnë në mënyrë profesionale kur vlerësojnë vulnerabilitetin e nxënësve, si dhe ndryshimet eventuale të cilat do t'i vërejnë tek nxënësit dhe t'i ndjekin për një periudhë të caktuar para se të veprojnë.

Aktivitetet të cilat i ndërmarrin mësimdhënësit nuk guxojnë dhe nuk duhet të shkatojnë efekt të kundërt. Për këtë qëllim, mësimdhënësi duhet ta njohë nxënësin e tij, ta identifikojë çdo sjellje devijuese, të pazakontë dhe të palogjikshme dhe në bazë të kësaj të ndërmarrë një sërë masash të cilat nuk do të shkaktojnë efekte të dëmshme. Të ketë kujdes që të mos kontribuojë për diskriminimin e nxënësit në bazë religjioze, racore apo etnike, të mos bëjë poshtërimin e tij, të mos e potencojë atë si problem, të mos e përjashtojë nxënësin nga kolektivi etj. Mësimdhënësit duhet të kenë një ndikim të fortë ndaj nxënësve me qëllim që t'i ndihmojnë ata të ndjehen të sigurt dhe krenarë për vetveten dhe arritjet e tyre. Në të njëjtën kohë, t'i ndihmojnë ata të ndjehen mjaftë të sigurt se janë të gatshëm dhe të aftë për të mësuar gjëra të reja.

1

FAZA E PARË - SJELLJA PROBLEMATIKE

Kjo kategori i karakterizon sjelljet individuale të cilat i paraqesin momentet për vetë-identifikim dhe ku individi fillon papritur ta ndryshojë sjelljen e tij, por edhe dukjen fizike.

Nxënësi tregon interes për tema të natyrës politike dhe në të njëjtën kohë përpiqet ta mbrojë qëndrimin e tij të formuar para familjes së tij dhe në shkollë;

Nxënësi përmes ndryshimit të dukjes së jashtme (tatuazhe specifike, veshje tradicionale, kokë të rruar, mjekër specifike, llak të zi në thonjtë e fëmijëve mashkullorë, simbole religjioze, simbole ideologjike etj.) e shprehë identitetin e tij ose ndjenjën e përkatësisë;

Nxënësi fillon në mënyrë aktive të artikulojë qëndrime në rrjetet sociale për tema ditore politike në vend, rajon dhe në korniza botërore;

Nxënësi tregon dëshirën për t'u bashkëngjitur në shoqata politike, grupe ideologjike dhe religjioze, të konvertohet në një religjion tjetër;

Nxënësi e shpreh nevojën për përjetime emocionale dhe aventuriere;

Shpreh qëndrime konkrete lidhur me polarizimin e shoqërisë në bazë sociale, partiake, etnike, religjioze dhe racore;

Del jashtë atmosferës familjare dhe shkollore, bëhet indiferent për aktivitetet sportive dhe të tjera shkollore, tërhiqet, i ndryshon shprehitë e tija, ndjehet i përjashtuar dhe fillon të izolohet;

2

FAZA E DYTË - SJELLJA SHQETËSUESE

Kjo kategori përfshin një grup sjelljesh të cilat do të mund të lidheshin me fillimet e angazhimit të individëve në procesin e radikalizimit. Karakteristikë për këtë grup është mosbesimi tashmë i inkorporuar ndaj botës së jashtme, posedimi i qëndrimeve të cilat e bëjnë legjitim përdorimin e dhunës për arritjen e qëllimeve të veta ose mbrojtja e një kauze të caktuar për të cilën është i/e përgatitur të luftojë dhe/ose ta mbrojë.

Lexon, predikon dhe shpërndan në mënyrë aktive qëndrime religjioze dhe ideologjike dhe literaturë në familje, fqinjë dhe shkollë;

I përjashton rregullat në shkollë dhe refuzon të marrë pjesë në aktivitete në grup ose të komunikojë me persona të caktuar për shkak të religjionit, etnikumit, gjinisë ose orientimit seksual;

Shprehë nevojën që të dominojë ose t'i kontrollojë të tjerët dhe të krijojë mbështetës;

Ndërpret marrëdhëniet me familjen dhe në shkollë me qëllim që ta fshehë dhe ta mbajë mënyrën e re të jetesës dhe rrethin e miqve dhe shokëve, përkatësisht shoqërinë e re;

Flet haptas për arsyeshmërinë e përdorimit të dhunës në mbrojtje të një kauze të caktuar kështu që bëhet më i afërt me dhunuesit dhe ekstremistët;

Manifeston përkatësinë e grupeve të njohura të dhunshme dhe ekstremiste kështu që shpreh urrejtje ndaj individëve dhe grupeve të tjera;

Shpreh preokupimin me fundin e botës, komenton profeci nga literatura fetare, preokupimin me personat historikë të karakterizuar sipas krimeve të njerëzimit.

3

FAZA E TRETË - SJELLJA ALARMANTE

Në këtë kategori përfshihen sjellje të ndryshme të cilat pohojnë gatishmërinë e individit ta shohë dhunën si një bazë e vetme legjitime dhe një mjet valid veprimi.

Merr pjesë ose inicion akte të sjelljes së dhunshme në shkollë dhe gjatë ndeshjeve sportive në shkollë, në fqinjësi dhe në familje;

Shpreh interes dhe i pyet mësimdhënësit e fizikës, kimisë dhe biologjisë se si të përdorë elementet specifike me të cilat mund të bëhet një pajisje eksplozive ose një armë vdekjeprurëse;

Si mësimdhënës, ju i dini më së miri nxënësit tuaj dhe ju jeni në pozitë më të mirë të dini nëse ata manifestojnë ndryshime ose sjellje të pazakonshme. Besoni në vetvete dhe në mendimin tuaj profesional dhe kërkoni këshillë nëse diçka nuk është në rregull dhe nëse nuk jeni të sigurt në mendimin tuaj.

Merr pjesë në fushata për grumbullimin e mjeteve financiare për nevojat e grupit të dhunshëm dhe ekstremist të cilave u takon ai;

Thërret nxënës të tjerë që t'i bashkohen grupit të dhunshëm dhe ekstremist dhe i nxit për aktivitete të kauzës;

Kontakton dhe vepron për nevojat e grupit të njohur dhe ekstremist përmes marrjes së instruksioneve nga rekrutues dhe udhëheqës;

Merr pjesë në udhëtime dhe aktivitete (kampe ideologjike-religjioze, ndeshje sportive si pjesë e një grupi të tifozëve, qarqe ndërkombëtare të një grupi të një baze të njëjtë ideologjike) për nevojat e grupit të dhunshëm dhe ekstremist jashtë vendbanimit;

Bën plan për udhëtim në zona ku grupet e dhunshme ekstremiste janë aktive, në rajone jostabile ose në zona të konfliktit.

Është e rëndësishme të theksohet se këta indikatorë mund të merren parasysh si shenja të mundshme për një proces të radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm atëherë dhe vetëm atëherë kur individi manifeston një kombinim të disa indikatorëve në të njëjtën kohë ose në një periudhë të vazhdueshme kohore. Po ashtu, nuk duhet ta zëvendësojnë vlerësimin e tërësishtëm të procesit të identifikimit të një individi të radikalizuar dhe gjithsesi nuk duhet të merren si një burim i vetëm sipas të cilit do të merren konkluzione.

Protokollet për parandalimin e radikalizimit

PROTOKOLLI PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZIMIT NË FAZË TË PARË “SJELLJA PROBLEMATIKE”

“Roli i mësimdhënësit si *dominuslitis*”

Sjellja e pazakonshme dhe problematike e nxënësit duhet të identifikohet nga ana e mësimdhënësit që në fazën e hershme. Në këtë fazë mësimdhënësi duhet ta ndër marrë rolin e *dominuslitis*-it dhe ta ngrejë një iniciativë për t'i larguar dukuritë e këtilla.

Përveç drejtimeve standarde mësimore, mësimdhënësit duhet të krijojnë kushte të përshtatshme dhe një mjedis të sigurt për mësim⁵ dhe për diskutime të hapura për çështje që lidhen me politikat aktuale

.....
⁵ Ligji për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme
TEKSTI I KONSOLIDUAR (Gazeta zyrtare e Republikës së
Maqedonisë) nr. 10/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe
67/2017)

qeveritare, çështje të ndryshme kontroverse dhe tema si radikalizmi që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Në fillim, ndoshta çështjet e këtilla do të jenë të vështira për t'i kuptuar të rinjtë dhe për t'u ballafaquar me to, por megjithatë ata nuk duhet të qëndrojnë larg këtyre temave, por përkundrazi, ata duhet t'i kontrollojnë emocionet e tyre dhe t'i zgjidhin të njëjtat, dhe të mësojnë të mendojnë për vetveten, gjë që u jep atyre mundësinë për të kontribuar për ndryshimet shoqërore si qytetarë të ndërgjegjshëm.

Sjellja e tërësishme e nxënësve dhe interaksioni me moshatarët dhe mësimdhënësit duhet të merren parasysh përmes një qasjeje holistike (gjithëpërfshirëse). Ka situata kur intervenimi është vital dhe i domosdoshëm. Nxitja e zhvillimit të të menduarit kritik ka

një rëndësi thelbësore për zhvillimin e nxënësve dhe duhet të merret parasysh kur merret vendim për të intervenuar.

Me pjesëmarrjen aktive në debate të këtilla, njerëzit e rinj mësojnë se si të argumentojnë, të mendojnë, t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, të mendojnë për qëndrime të ndryshme dhe t'i zgjidhin konfliktet. Këto aftësi do t'u mundësojnë atyre të fitojnë vetëbesim dhe të ndërtojnë rezistencë për të menaxhuar me konfliktet, me të cilat do të takohen çdo ditë në jetën e tyre qoftë në shtëpi, jashtë apo në bashkësinë e tyre lokale, por edhe si një përgjigje ndaj problemeve globale dhe kërcënimeve nga idetë ekstremiste dhe terroriste.

Prandaj në vazhdim, përmes sfidave dhe aksioneve konkrete, do t'i ndihmojmë mësimdhënësit që t'i bëjnë klasat e tyre vende të sigurta për diskutim të lirë dhe të hapur për çështje dhe tema kontroverse (shiko aneksin 1).

“Çështjet kontroverse janë mundësi të vlefshme për mbajtjen e bisedimeve të rëndësishme në klasë, sepse vlerat dhe idetë hulumtohen në një hapësirë të sigurt”.

OKSFAM (Të mësuarit e çështjeve kontroverse)

Aktivitetet e propozuara për mësimdhënësin gjatë zbulimit të sjelljes problematike:

- ✓ Obligoni nxënësit që t'i vendosin rregullat dhe përgjegjësitë në klasë;
- ✓ Bisedoni haptas me nxënësit për dhunën, radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin si dhe për pasojat e tyre;
- ✓ Mësoni nxënësit për të drejtat e tyre, si dhe për të drejtat e moshatarëve të tyre, mësimdhënësve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe anëtarëve të komunitetit;
- ✓ Zbatoni masat disiplinore që janë instruktive, e jo ndëshkuese;
- ✓ Diskutoni haptas me nxënësit për tema që mund të nxisin dhunë;
- ✓ Bisedoni haptas për dallimet e religjioneve dhe besimeve;
- ✓ Parashtrijuni pyetje nxënësve: Cilat të drejta specifike nuk respektohen gjatë akteve të dhunës?
- ✓ Cilat të drejta specifike nuk respektohen në aktin e dhunës;

- ✓ Propozoni mënyra me të cilat do të ngrihet vetëdija për të drejtat njeriut në shkollë dhe promovoni respektimin e dallimeve, për shembull përmes debateve, mësimit në natyrë, lojërave, luajtjes së roleve dhe tregimit të përrallave;
- ✓ Propozojuni nxënësve të formojnë një klub kundër dhunës;
- ✓ Ndhmoni ata të organizojnë aktivitete për promovimin e një fushate të qetë dhe një mjedis të sigurt shkollor për të gjithë;
- ✓ Ndani kohë pas mësimit ose gjatë pushimit për të biseduar për sjelljen e keqe – pse ka ndodhur dhe çfarë duhet të ndërmerret që të përmirësohet ajo;

Filloni një diskutim duke përdorur frazat që vijojnë:

- *Çfarë ndodh këtu?*
- *Çfarë është ajo gjë interesante që ndodh atje?*
- *Për cilën gjë grindemi?*
- *Pse dhe si u paraqit ky problem?*
- *A do të më thotë dikush ndonjë fjalë të bukur për shokun e tij?*
- *Çfarë mendoni ju për shokët tuaj?*
- *Le të flasim për të drejtat e njeriut dhe liritë sot?*

- *Pse mendoni se është e nevojshme që të kemi një diskutim për atë gjë?*

- ✓ Jini mbikëqyrës dhe dëgjues!
- ✓ Bëni një simulim të dhunës dhe vëreni pasojat!
- ✓ Mos i përjashtoni dhe mos i ndërpritni nxënësit në parashtrimin e pyetjeve!
- ✓ Jini të gatshëm dhe demonstroi tolerancë për komentet që janë të ndryshme me komentet tuaja!
- ✓ Angazhohuni për mekanizma për paraqitje (shërbim profesional ose on-line) të cilat do t'i nxisin nxënësit të flasin kundër shenjave të radikalizmit dhe dhunës!
- ✓ Inicioni krijimin e një platforme on-line për edukim dhe parandalim të radikalizmit dhe dhunës të dedikuar për nxënësit!

Mësimdhënësi duhet ta analizojë seriozitetin e situatës, ta ndjekë të njëjtën për një periudhë të caktuar dhe varësisht nga situata, nëse nuk ka përmirësim, duhet të vendosë nëse do ta dërgojë nxënësin te pedagogu, psikologu ose drejtori i shkollës ose do ta thërrasë prindin e fëmijës në një bisedë informative me qëllim që ta njoftojë për situatën e ndodhur.

Protokoli për parandalimin e radikalizmit në fazën e dytë "sjellja shqetësuese"

Siç është cekur edhe në shpjegim, në këtë fazë mund të vërehen fenomene të caktuara devijuese në sjelljen e nxënësit. Aktivitetet e nxënësve në këtë fazë janë në vijën e kufirit midis gjërave të ligjshme dhe atyre të paligjshme. Megjithatë, çdo aktivitet është i pazakontë dhe jashtë sjelljes normale të nxënësve. Mosinteresimi ose mosangazhimi i stafit mësimdhënës në këtë fazë mund të shkaktojë një zgjerim të dukurisë. Këtu mësimdhënësi duhet t'i vërejtë shenjat e para të sjelljes radikale të nxënësit. Jo gjithmonë, por mund të paraqitet një situatë kur aktivitetet devijuese të nxënësit mund të vërehen drejtpërdrejtë sipas indikatorëve të fazës së dytë. Në këtë fazë, jo gjithmonë mësimdhënësi mund të jetë dominuslitis në rolin parandalues. Në këtë fazë është i nevojshëm bashkëpunimi i aktorëve të tjerë në shkollë, prindërve, shërbimit profesional ose këshillat lokalë në bashkësi, të cilët duhet të japin kontributin e tyre në parandalimin dhe pengimin e nxënësve që t'i kryejnë këto dukuri.

Çfarë duhet të bëjë mësimdhënësi në kuadër të kompetencave të tij?

HAPI 1

Mbikëqyrje, hetim dhe kuptimin e shkaqeve për sjelljen specifike devijuese të nxënësit;

HAPI 2

T'i ndërmarrë aktivitetet të cilat janë të parapara në Protokollin e parandalimit të fazës së parë, me qëllim që të përpiqet ta pengojë ose ta bindë nxënësin se veprimet dhe aktivitetet që i kryen nuk janë karakteristike për të dhe japin një shembull të keq për të tjerët dhe se të njëjtat nuk janë në përputhje me Kodin e sjelljes në shkollë;

HAPI 3

Ta thërrasë prindin e nxënësit me qëllim që ta informojë për sjelljen e tij devijuese, të pazakonshme dhe të pazakontë dhe se e njëjta nuk është në përputhje me Kodin e sjelljes në shkollë;

HAPI 4

T'i informojë pedagogun, psikologun, drejtorin, si dhe këshillin e shkollës dhe të mësimdhënësve për paraqitjen e sjelljeve devijuese, të pazakonshme dhe të pazakonta te nxënës të caktuar me qëllim që të njëjtët të ndërmarrin masa përkatëse.

Në këtë fazë ka mjaft elemente që drejtorja e shkollës ta informojë këshillin lokal në bashkësi, si dhe njësinë lokale të policisë për dukurinë e paraqitur, të cilët pastaj kanë obligim që ta ndjekin atë dhe të ndërmarrin masa për pengimin e këtyre dukurive të nxënësit. Për këtë qëllim, rekomandojmë të formohet një qendër për paraqitje në bashkësinë lokale, e cila do të ketë një platformë telefonike ose on-line për paraqitjen e këtyre dukurive.

Protokolli për parandalimin e radikalizmit në fazën e tretë “sjellja alarmante”

Nxënësit në këtë fazë shpeshherë mund ta kalojnë kufirin e veprimtarive të lejuara dhe të ndërmarrin aktivitete brenda shkollës që janë të paligjshme dhe të dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë. Akti i maltretimit, ofendimi i rëndë, rrezikimi i sigurisë së dikujt ose kryerja e dhunës së rëndë duke shkaktuar ndjenjën e pasigurisë, janë akte të dënueshme. Varësisht nga ajo nëse nxënësi e ka bërë këtë vetë ose në grup, varet edhe lartësia e dënimit. Neni 386 i Kodit Penal gjithashtu ndëshkon dhunën që kryhet gjatë një ndeshjeje sportive. Në këtë kontekst, edhe pjesëmarrja në rrahje dhe akte të dhunës në të cilat humbet jeta e dikujt ose në ndonjë mënyrë tjetër i shkaktohen lëndime trupore

ose lëndime të rënda trupore një personi tjetër, është një vepër që dënohet me ligj.

Edhe tallja (përqeshja) me simbolet kombëtare, etnike ose fetare gjithashtu dënohet me ligj. Aktivitetet e këtilla mund të nxisin një urrejtje nacionale, fetare dhe racore, përçarje dhe padurim. Në këtë fazë të sjelljes alarmante, nxënësit mund të kryejnë pa vetëdije aktivitete të këtilla, duke mos ditur se ato janë të dënueshme me ligj.

Thirrja e personave të tjerë t'i bashkohen grupit, të cilin e përfaqëson një nxënës, nuk paraqet vepër penale deri në momentin kur i njëjti grup do të fillojë të kryejë akte të dhunës. Në këtë rast, thirrësi me vetëdije ka thirrur nxënësit e tjerë t'i bashkohen grupit me qëllim që i njëjti grup të rrisë numrin e pjesëtarëve dhe të fitojë fuqi. Vetë akti i formimit të grupeve në shkollë dhe thirrja e nxënësve të tjerë për t'u bashkuar është një aktivitet i pazakonshëm për fëmijët, i cili kërkon nga mesimdhënësi që të vëzhgojë, hetojë, kuptojë dhe t'i përgjigjet pyetjes se pse një nxënës i caktuar apo nxënës të caktuar formojnë grup. Ky mund të jetë një indikator i fortë i cili do ta drejtojë mesimdhënësin për të ndjekur zhvillimin e situatës dhe për të përcaktuar qëllimin përfundimtar të grupit.

Grumbullimi i mjeteve për nevojat e grupit nuk është një vepër e dënueshme. Por, nëse mjetet grumbullo-

hen me qëllim që ato të përdoren për të kryer dhunë, atëherë personi i cili grumbullon mjetet me vetëdije/ pa vetëdije kryen një veprë penale.

Po ashtu dënohet me ligj edhe përgatitja për të shkuar dhe për të marrë pjesë në zona ku janë aktive grupe të dhunshme ekstremiste, në rajone jostabile ose në zona të konfliktit.⁶

Edhe pse kompetencat e stafit mësimdhënës për veprim parandalues në këtë fazë të aktiviteteve të nxënësve janë të tejkaluara, megjithatë çdo vërejtje të aktiviteteve të këtilla brenda shkollës duhet të konstatohet dhe të paraqitet në mënyrë përkatëse te prindërit e nxënësve ose ta informojnë drejtorinë e shkollës. Roli i mësimdhënësit në këtë fazë nuk do të ndryshojë nga rolet që i ka ai në fazat paraprake. Ai duhet të bëjë përsëri mbikëqyrje, hetim dhe kuptimin e shkakut për sjelljen e pazakonshme dhe aktivitetet e nxënësve dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme në përputhje me kompetencat e tij/saj.

.....
⁶ Teksti i pastruar i përmban këto ndryshime dhe plotësime të ligjit, të publikuara në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 80/99, numër 4/2002, numër 43/2003, numër 19/2004, numër 81/2005, numër 60/06, numër 73/06, numër 7/08, numër 139/08, numër 114/09, numër 51/11, numër 135/11, 185/11, numër 142/12, numër 166/12, numër 55/13, numër 82/13, numër 14/14, numër 27/14, numër 28/14, numër 115/14 dhe numër 132/14.

Çfarë duhet të bëjë mësimdhënësi në kuadër të kompetencave të tij?

HAPI 1

Mbikëqyrni, hetoni dhe kuptoni shkaqet për sjelljen specifike devijuese të nxënësit;

HAPI 2

Ndërmerrni aktivitetet të cilat janë të parapara në Protokollin e parandalimit të fazës së parë, me qëllim që të përpiqeni ta pengoni ose ta bindni nxënësin se veprimet dhe aktivitetet që i kryen nuk janë karakteristike për të dhe janë një shembull i keq për nxënësit e tjerë dhe se aktivitetet e tilla nuk janë në përputhje me Kodin e sjelljes në shkollë;

HAPI 3

Thirrni prindin e nxënësit që ta informoni për sjelljen e tij devijuese, të pazakonshme dhe të çuditshme dhe për aktivitetet e nxënësit dhe se ajo nuk është në përputhje me Kodin e sjelljes në shkollë;

HAPI 4

Informoni pedagogun, psikologun, drejtorin, si dhe këshillin e shkollës dhe të mësimdhënësve për paraqitjen e sjelljes devijuese, të pazakonshme dhe të çuditshme tek nxënës të caktuar me qëllim që të ndërmarrin masa përkatëse.

VËREJTJE

- ✓ Është shumë e rëndësishme për mësimdhënësin që ta kuptojë rolin e tij parandalues përmes identifikimit të shenjave të hershme të radikalizmit që mund të çojë në dhunë. Në asnjë rast, mësimdhënësi nuk guxon të marrë rolin e zyrtarit policor ose shërbimit të inteligjencës. Kjo mund të shkaktojë një efekt të kundërt, përkatësisht ulje të mirëbesimit në mes të mësimdhënësit dhe nxënësit duke komprometuar marrëdhëniet e tyre.
- ✓ Nëse te nxënësi vërehet një sjellje devijuese, e cila është e palogjikshme dhe e pazakonshme për të (refuzimi i autoritetit, mohimi i komunitetit etj.), kjo nuk do të thotë se nxënësi është i radikalizuar.
- ✓ Nëse te nxënësi vërehet një sjellje devijuese, e cila është e palogjikshme dhe e pazakonshme për të dhe i njëjti me vetëdije ose pa vetëdije ndërmerr aktivitete që dënohen me ligj, mësimdhënësi është i obliguar që ta informojë drejtorinë e shkollës për dukurinë e detektuar.
- ✓ Gjatë ndërmarrjes së masave, të cilat e kthejnë nxënësin nga sjellja e tij devijuese, mësimdhënësi duhet të ketë vëmendje të mos kontribuojë për diskriminimin e nxënësit në bazë fetare, racore ose etnike, të mos bëjë poshtërimin e tij, të mos e theksojë atë si problem, të mos e përjashtojë nxënësin nga kolektivi etj. Masat e tilla mund të jenë kundër-produktive.

SHTOJCA 1

RASTE PRAKTIKE

1

Situata 1: Si duhet të bisedoj me nxënësit e mi lidhur me çështje të ndjeshme, siç janë radikalizmi që çon në dhunë, ekstremizëm, terrorizëm, konflikte luftarake e ngjashme?

Sfida e mësimdhënësve: Shumë mësimdhënës nuk ndjehen të sigurt të bisedojnë për këto tema, madje disa fare nuk merren me këto tema, kështu që i shmangin pyetjet e këtilla të cilat ua parashtrojnë nxënësit e tyre, duke pohuar se çështjet e këtilla nuk duhet të diskutohen fare dhe se situata mund të dalë jashtë kontrollit. Megjithatë, çështjet e këtilla janë shumë të rëndësishme për nxënësit dhe të njëjtat nuk duhet të shmangen nga ana e mësimdhënësve për shkak se nëse nxënësit nuk

i marrin këto përgjigje prej tyre, do t'i kërkojnë ato jashtë shkollës dhe më së shpeshti marrin përgjigje të gabueshme, të cilat i nxisin të marrin anën tjetër, anën e gabuar.

Opsioni për veprim: Është shumë e rëndësishme që shkollat të ofrojnë mundësi për të rinjtë për të diskutuar për çështje të këtilla. Nëse nxënësit nuk kanë mundësi, ata do t'i kërkojnë përgjigjet në vende të tjera dhe shpesh të gabuara. Tashmë kemi përmendur se moshë i bën të rinjtë shumë të rrezikshëm ndaj propagandave dhe qëndrimeve negative ekstremiste. Për këto arsye, vendet e këtilla të sigurt për të biseduar, ku do të mund t'i shprehin dhe t'i ndajnë lirisht mendimet dhe shqetësimet e tyre, janë të domosdoshme. Ju, si mësimdhënës, duhet të jeni të përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve të këtilla që nuk duhet

të jenë pjesë e programit tuaj mësimor. Është e rëndësishme që në situata të këtilla, në mënyrë të qetë të hapni një diskutim në të cilin, përveç individit i cili parashtron pyetjen, do t'i përfshini edhe nxënësit e tjerë, veçanërisht ata që janë pasiv dhe nuk tregojnë interes. Në këtë mënyrë, nxënësit do të kenë mundësi t'i shprehin qëndrimet e tyre bashkërisht, të mësojnë t'i dëgjojnë dhe t'i respektojnë qëndrimet e të tjerëve. Nëse ju si mësimdhënës jeni përgatitur paraprakisht për situatat e këtilla (çështje kontroverse), kjo në masë të madhe do t'ua reduktojë frikën dhe suksesi në zhvillimin e diskutimit konstruktiv do të jetë më i madh.

Nëse situata del jashtë kornizave të diskutimit të lejuar dhe nuk mund të vazhdojë, sugjerimi është që mësimdhënësi të gjejë një mënyrë për ta qetësuar situatën (për shembull: me gjestikulim të duarve), ndërsa pas përfundimit të mësimit ta njoftojë drejtorin me qëllim që të ndërmerren masa të tjera të domosdoshme, të cilat janë në përputhje me rregulloret e brendshme shkollore.

2

Situata 2: Si duhet të ballafaqohem me konflikte të cilat ndodhin midis nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike ose fetare?

Sfida: Konfliktet midis personave të rinj të kësaj moshe shkollore, të cilët kanë mendime të ndryshme, janë normale. Megjithatë, konfliktet e këtilla mund të rriten në qoftë se bëhet fjalë për përfshirjen e temave të sferës së religjionit apo qëndrime të caktuara për mënyrën e jetesës dhe të ngjashme. Në këtë situatë, mësimdhënësi do të duhet të jetë i kujdesshëm që të mos marrë anë dhe të mos ofendojë ndonjërin nga nxënësit. Nëse nxënësi ose grupi i nxënësve kanë qëndrime dhe marrin anë, fillojnë të ofendohen me njëri-tjetrin dhe përdorin gjuhën e urrejtjes, atëherë do të duhet menjëherë të fillojë një diskutim në të cilin do të përfshihen të gjithë nxënësit, me qëllim të pranimit të përbashkët dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Diskutimi duhet të jetë konstruktiv dhe çdokush që dëshiron të flasë duhet t'i jepet mundësi dhe të mos lejohet që askush të dominojë në situatë.

Opsioni për veprim: Sa i përket çështjes së mënyrës së jetesës, ju si mësimdhënës mund të filloni të diskutoni në mënyrë taktike me nxënësit tuaj për temën e diskriminimit në mënyrë që t'i ndihmoni ata të vendosin rregulla të respektit të ndërsjellë. Gjithashtu, mund t'i theksoni përfitimet që i sjell diversiteti në një shoqëri dhe se një nga këto përfitime del nga fakti se respektimi i diversitetit ruan bashkëjetesën dhe empatinë.

Sa i përket temës fetare të përfshirë në konflikte që mund të ndodhin mes nxënësve, ju si mësimitdhënës mund të theksoni se jo të gjitha konfliktet në korniza botërore ndodhin gjithmonë si rezultat i dallimeve të religjionit. Republika e Maqedonisë është një shembull i një shteti shumëkonfesional dhe multietnik, dhe është një shembull i shkëlqyeshëm i respektimit dhe ruajtjes së religjioneve të ndryshme dhe tolerancës në këtë drejtim. Është shumë e rëndësishme kur diskutojmë për këtë temë, t'u tregojmë nxënësve se konfliktet nuk janë zgjidhje për çështjet e këtilla, por se zgjidhja e vetme qëndron në dialogun dhe respektimin reciprok të dallimeve, prej të cilave, siç thamë, duhet të dalin pasojat pozitive, e jo negative.

Nëse konflikti vazhdon të zgjasë edhe më tej edhe në orët e tjera, atëherë është e domosdoshme që të njoftohet drejtori i shkollës, por pa e ditur nxënësit, me qëllim që të ndërmerren masa të tjera që janë në përputhje me rregulloren e shkollës.

3

Situata 3: Çfarë nëse nxënësi gjatë orës së edukatës fizike, gjatë lojës sportive fillon t'i ofendojë (në bazë racore, etnike, gjinore etj.) shokët e tij në mënyrë verbale, por edhe fillon të veprojë në mënyrë agresive dhe t'i shtyjë, t'i rrahë dhe ngjashëm?

Sfida: Është e mundshme të ketë situata kur, për shkak të frustracioneve dhe padrejtësive të ndryshme që i përjeton ndonjë fëmijë brenda dhe jashtë shkollës, manifestohen dukuri të këtilla. Paraqitet një dilemë në këtë moment nëse ka shqetësime se kjo do të mund të ishte një shenjë e hershme për identifikimin e radikalizmit të individit që mund të çojë në dhunë. Nga pika e parë e këndvështrimit, kjo është mosha kur të rinjtë zakonisht manifestojnë marrëdhënie të këtilla, por megjithatë siç është përshkruar në pjesën e indikatorëve, nuk duhet të merret vetëm një indikator, por duhet të perceptohet dhe të ndiqet gjendja e nxënësit për një periudhë të caktuar, si në atë orë ashtu edhe në bisedë me kolegët edhe në orët e tjera.

Opsioni për veprim: Në këtë rast, së pari do të duhej ta ndërpritnit për pak lojën sportive dhe ta pyetni nxënësin se çfarë është problemi, përjashtimin nga loja ose dëbimin nga ora assesi mos e merrni si opsion. Nëse ka vend, sugjerimi është të filloni një diskutim dhe t'i përfshini edhe nxënësit e tjerë, dhe bashkërisht në mënyrë konstruktive të përpiqeni ta qetësoni situatën dhe të gjeni një zgjidhje për problemin. Ju si mësimitdhënës në këtë situatë duhet ta shpjegojë qëllimin e aktiviteteve sportive dhe anën pozitive të lojës kolektive, se sporti nuk i ndan njerëzit në bazë racore, fetare, gjinore apo etnike dhe se së bashku mund të arrijmë më

shumë. Si një shpjegim i kësaj, rekomandohet që t'i jepni shembujt e shumtë të klubeve të futbollit, hendbollit, basketbollit dhe klubeve të tjera, të cilat në radhët e tyre kanë lojtarë që vijnë nga e gjithë bota dhe se të gjithë ata i bashkon vetëm një gjë e vetme, dëshira për të fituar ndeshjen.

4

Situata 4: Çfarë nëse nxënësi kërkon prej meje ta liroj nga ora për të shkuar të kryejë një ritual fetar?

Sfida: Gjatë ballafaqimit me kërkesën e këtillë nga ana e nxënësit, është shumë e rëndësishme në këtë situatë që mësimitdhënësi, nëse nuk ka njohuri paraprake për mënyrën dhe kohën e kryerjes së ritualit fetar, të informohet paraprakisht në mënyrë që t'i përgjigjet kërkesës në mënyrë adekuate. Përgatitja paraprake e mësimitdhënësit do të mundësojë që në një mënyrë më të sigurt dhe të thjeshtë të japë një shpjegim të duhur për vendimin që do të merrej në drejtim të kërkesës së këtillë nga ana e nxënësit.

Opsioni për veprim: Bisedoni me nxënësin dhe i thoni atij se e kuptoni dhe respektoni orientimin religjioz dhe praktikën e riteve fetare dhe shpjegoni se shteti ynë është sekular dhe edukimi është i ndarë nga mësimi religjioz dhe praktika e ritualeve fetare derisa janë në shkollë. Bëni të qartë se i

dini mënyrat dhe periudhat kohore të praktikës së riteve fetare dhe se këto praktika nuk duhet të zbatohen menjëherë, por pas një periudhe të caktuar të njëjtën ditë, me ç'rast do të kuptohet se kjo kërkesë nuk qëndron. Pastaj, shpjegoni se institucionet arsimore në programin mësimor i përfshijnë edhe bazat e religjioneve, por i njëjti nuk praktikon ritualet fetare në objektet shkollore, por edhe se mësimi arsimor nuk duhet të ndërpritet, të cilën gjë do ta konfirmonin edhe udhëheqësit fetarë, nëse i pyet. I thoni atij se vendimi për t'i lëshuar nxënësit që të mungojnë në mësimet do të ketë pasoja për mësimitdhënësin. Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksoni se vendimi i këtillë nuk është i lidhur me lirinë e religjionit, por me rregullat dhe sigurinë e nxënësve në rrethin e sistemit arsimor dhe me kodin e sjelljes në shkollë.

Nëse nxënësi nuk e dëgjon mësimitdhënësin dhe del nga mësimi pa leje dhe nëse praktika e këtillë vazhdon, atëherë do të duhej të përfshihej personeli pedagogjik i cili do t'i informonte, thërriste dhe përfshinte prindërit e tij në një diskutim konstruktiv, me qëllim që bashkërisht ta zgjidhin problemin. Nëse edhe kjo nuk ka sukses, atëherë është e domosdoshme që të përfshihet edhe drejtori i shkollës, me qëllim që të ndërmerren masa të tjera të cilat janë në përputhje me rregulloren e shkollës.

5

Situata 5: Çfarë duhet të bëj nëse nxënësi në orën e kimisë ose fizikës interesohet për disa elemente specifike kimike të cilat janë të lidhura me përgatitjen dhe konstruimin e një mjetei eksploziv, jep shembuj dhe i lavdëron sulmet ndaj njerëzimit nga konflikte të caktuara të kaluara ose aktuale?

Sfida: Orët e kimisë dhe fizikës mund të tërheqin një interes dhe pyetje të ndryshme nga ana e nxënësve. Mësimdhënësi duhet të vlerësojë ndjeshmërinë e njësisë tematike të cilën do ta ligjërojë dhe t'i parashikojë çështjet e ndjeshme. Në situatën e këtillë do të duhet ta drejtojë bisedën në drejtim të theksimit të karakteristikave pozitive të njësisë tematike nga të cilat mund të ketë përfitime.

Opsioni për veprim: Vendoseni veten në pozicion se pyetja rreth elementeve kimike është interesante dhe shpjegoni vetitë kimike. Këtu është më mirë të aktivizoni një diskutim dhe ta drejtoni bisedën në drejtim të marrjes së përgjigjeve, si për shembull çfarë është ajo që ka nxitur nxënësin ta parashtrijë pyetjen dhe të ketë interes, duke i shpjeguar atij gradualisht se për më shumë njohuri nxënësi mund të jetë prezentë në mësimet shtesë - seksione të fizikës dhe kimisë, ku kryhen edhe eksperimente të veçanta. Në një situatë të

këtillë, mësimdhënësi do të mund të mësojë nëse nxënësi ka parashtruar pyetjen vetëm për shkak të kureshtjes së tij dhe që të jetë interesant për bashkëmoshatarët e tij në klasë nga njëra anë, apo nëse nxënësi është këmbëngulës dhe insiston që të mësojë ndonjë qëllim të veçantë, në anën tjetër. Gjithashtu, në qoftë se interesi është shoqëruar me lëndë dhe komente në lidhje me ngjarje që lidhen me sulme me bomba kundër njerëzimit, atëherë është një element shtesë që i jep një sinjal mësimdhënësit se te nxënësi ka një intencë për mendim të dhunshëm ekstrem. Nëse nxënësi tregon interes për të qenë pjesë e seksionit, atëherë mësimdhënësi do të kalojë në një fazë kur do të ketë “kontroll” mbi interesin dhe sjelljet e nxënësit.

Nëse nxënësi nuk e pranon propozimin e mësimdhënësit për të marrë pjesë në mësimet shtesë, atëherë mësimdhënësi do të vazhdojë ta monitorojë dhe ta ndjekë këtë nxënës për një periudhë të caktuar nëse do të parashtrijë pyetje të këtilla ose të ngjashme.

6

Situata 6: Çfarë nëse nxënësi gjatë festave fetare agjëron dhe humb koncentrimin në mësim dhe nuk merr pjesë në diskutim?

Sfida: Ka nxënës në Maqedoni të cilët gjatë festave fetare dhe agjërimeve përmbahen nga konsumimi i ushqimeve dhe pijeve të caktuara që situata e këtillë i bën të ndjehen fizikisht më të dobët, mendërisht të papërgatitur për t'i ndjekur orët mësimore. Rastet e këtilla janë të shumta dhe janë prezente te shumë nxënës të rinj edhe në shkollat fillore.

Opsioni për veprim: Në raste të këtilla është më mirë që ju si mësimdhënës të bisedoni me prindërit e atyre nxënësve dhe t'u shpjegoni se ata janë ende fëmijë dhe të rinj që të përmbahen nga ushqimi dhe uji dhe se kjo mund të ndikojë së pari ndaj shëndetit të tyre, e pastaj ndaj koncentrimit dhe suksesit të tyre në shkollë. Pastaj, përmes një diskutimi të sqartë dhe të hapur, ju duhet t'u shpjegoni nxënësve se e kuptoni dëshirën për të praktikuar obligimet fetare, por se përveç pjesës edukative, ju jeni përgjegjës edhe për shëndetin dhe sigurinë e tyre në shkollë dhe për këtë arsye me brengosje duhet t'ua shpjegoni efektet negative që mund të ndodhin.

Nëse nxënësi nuk e dëgjon mësimdhënësin dhe vazhdon të jetë i dekoncentruar dhe nuk e ndjek mësimin, si dhe aktivitetet e tjera aktuale shkollore, atëherë është e domosdoshme përsëri të përfshihen prindërit në diskutimin e përbashkët.

7

Situata 7: Çfarë nëse nxënësi refuzon të marrë pjesë në festimet e përbashkëta të shkollës (netët e maturës, festimet e vitit të ri, ngjarjet tradicionale, ekskursionet jashtë qytetit ose vendit dhe ngjashëm)?

Sfida: Organizimi dhe mbajtja e ngjarjeve të këtilla nganjëherë nga ndonjë nxënës ose grup nxënësish has në mohim ose mospranim për të marrë pjesë. Rrallë, por ka raste të këtilla kur disa nxënës për shkaqe të ndryshme nuk duan të jenë pjesë e aktiviteteve të këtilla shkollore. Zakonisht nxënësit nuk japin njëfarë shpjegimesh të qëndrueshme dhe mund të lidhen me qëndrime fetare, tradicionale dhe kulturore, por edhe me mungesën e dëshirës për t'u shoqëruar me nxënësit e tjerë. Nganjëherë vendimi mund të jetë i imponuar edhe nga ana e prindërve, të cilët në situata të këtilla zakonisht janë të brengosur për sigurinë e fëmijës së tyre ose shkaqet mund të jenë edhe nga një pikëpamje financiare. Pastaj, disa prindër janë të brengosur për shkak të udhëtimeve dhe argëtimeve të këtilla për arsye se në këto situata fëmijët relaksohen shumë lehtë dhe mund të vijnë në kontakt me alkoolin dhe drogën.

Opsioni për veprim: Në raste të këtilla, do të ishte më mirë që ju si mësimdhënës së pari të bisedoni me këta nxënës me qëllim që t'i merrni arsyet për

mohimin e tyre. Pasi që do të merrni arsyen e vërtetë, në qoftë se shkakun janë prindërit, atëherë do të ishte më mirë që të bisedoni me ta dhe të përpiqeni t'i bindni se mësimdhënësit do të kujdesen për fëmijët e tyre sikur të jenë të tyre dhe se kjo do të ndikojë negativisht ndaj fëmijës së tyre, gjegjësisht e ndan atë nga shokët e tij. Gjithashtu, në qoftë se bëhet fjalë për ekskursione dhe ngjarje tradicionale, është e domosdoshme që t'i informoni me kohë prindërit, por edhe nxënësit se këto aktivitete janë pjesë e programit mësimor. Sa i përket netëve të maturës, përpiquni t'u shpjegoni fëmijëve dhe prindërve se kjo ngjarje është ndoshta shoqërimi i fundit i përbashkët me bashkëmoshatarët e tyre, sepse pas përfundimit të shkollës së mesme ata do të ndahen dhe secili do të shkojë nëpër rrugën e vet dhe kush e di nëse dhe kur do të takohen përsëri. Nëse shkakun është i natyrës financiare, atëherë ju mundeni së bashku me nxënësit e tjerë të organizoni mbledhjen e mjeteve për të ndihmuar nxënësin me qëllim t'i mundësohet atij që të jetë pjesë e aktiviteteve të përbashkëta shkollore.

Nëse mësimdhënësi nuk arrin t'i bindë ata, dhe në qoftë se disa aktivitete nuk ndikojnë ndaj suksesit të nxënësit, atëherë nuk ka mënyra që nxënësit dhe prindërit të jenë të detyruar të bëjnë diçka

që thjesht mendojnë se nuk është e nevojshme dhe nuk duan ta bëjnë.

8

Situata 8: Nëse në klasë dikush nga nxënësit përmend diçka lidhur me teorinë e konspiracionit, si duhet të reagoj?

Sfida: Disa nxënës mund të fillojnë të flasin në tema për ngjarje momentale politike dhe të qëndrojnë me kokëfortësi në qëndrimet e tyre. Mund të bëhet fjalë për konflikte luftarake, tensione fetare dhe etnike dhe të ngjashme. Nxënësit në situata të këtilla mund të shprehin qëndrime dhe të pohojnë disa teori se të gjitha luftërat në botë janë nisur nga një komb i caktuar, i cili ka mendime të këqija për kombet e tjera. Argumentet dhe teoritë e këtilla të konspiracionit, të rinjtë i gjejnë zakonisht në internet, si një nga instrumentet kryesore në kohën e sotme për zgjerimin e propagandës.

Opsioni për veprim: Është fakt se shkollat tona dhe stafi mësimdhënës realisht nuk janë të përgatitur që të mund t'u përgjigjen këtyre pyetjeve, por në bashkëpunim me institucione të caktuara ose me sektorin civil do të mund të organizonin dhe të zbatonin projekte edukative për ngjarje aktuale në vend dhe jashtë vendit. Analizat, teoritë dhe mendimet e këtilla do të mund të ishin pjesë e

procesit arsimor në lëndët e historisë, filozofisë, gjeografisë etj.

Në situata të këtilla, ju si mësimdhënës, duhet të vendosni kontroll mbi komunikimin dhe nuk duhet ta kritikoni menjëherë nxënësin për qëndrimet e tij. Bëni atmosferë për diskutim të hapur dhe përfshini nxënësit e tjerë në bisedë, duke kërkuar prej tyre që ta shpjegojnë dhe arsyetojnë mendimin e tyre për temën konkrete. Nëse ka qëndrime të ndryshme mes nxënësve, mundësoni një diskutim konstruktiv në të cilin mund të kërkonit prej secilit prej tyre të shprehin argumente dhe fakte me të cilat do të konfirmonin teorinë e tyre alternative, në këtë mënyrë nxënësit do të mësohen të dëgjojnë në mënyrë aktive me njëri-tjetrin, por edhe t'i pranojnë dhe t'i kuptojnë qëndrimet e ndryshme. Është mirë gjithashtu të hapni një diskutim edhe për të marrë informacione, me çka do të theksonit se në kohën e sotme ka shumë “lajme të rreme” dhe “teori të konspiracionit”, qëllimi kryesor i të cilave është shtrembërimi i së vërtetës.

Ju si mësimdhënës duhet t'u shpjegoni nxënësve se nuk duhet të injorohen problemet dhe çështjet lokale, kombëtare dhe globale, përkundrazi, ato duhet të diskutohen me qëllim që të mund të zgjidhen. Në këtë drejtim mund të hapen tema të diskutimit për gjuhën e urrejtjes, diskrimin-

imin dhe ksenofobinë me tregimin e shembujve të ndryshëm në botë të cilët kanë prekur grupe të ndryshme të komuniteteve etnike, fetare dhe të tjera, me qëllim që t'u tregohet se ngjarjet e këtilla kanë ekzistuar gjithmonë dhe se nuk janë të dedikuara vetëm për një komunitet.

9

Situata 9: Si të veprojmë nëse nxënësi në orën e biologjisë ose një lënde tjetër, e cila merret me proceset biologjike dhe krijimin e botës dhe jetën në planet, mohon qëndrimet e shkencës dhe thotë se librat e njerëzimit (Kurani ose Bibla), varësisht nga religjioni i nxënësit, është vetëm ai të cilit i beson dhe refuzon të dëgjojë dhe të ndjekë mësimin e tillë?

Sfida: Është e mundur që ndonjë nxënës të mos pajtohet me disa teori të cilat i thotë shkencë dhe nuk janë në përputhje me librat e shenjtë. Nëse merret si shembull krijimi i njeriut, shkencë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë që e thonë librat e shenjtë se bota dhe njerëzimi janë krijuar nga “Zoti/Allahu”, por kjo nuk duhet të jetë një shkak për konflikt, por përkundrazi duhet të merret si mundësi për një diskutim të shkëlqyeshëm midis nxënësve, në të cilin do të mund të debatonin dhe të shkëmbenin argumente të qëndrueshme me çka do të krijonin një

atmosferë të një tolerance të përbashkët midis pikëpamjeve të ndryshme intelektuale, kulturore dhe religjioze.

Opsioni për veprim: Në një situatë të këtillë, dëgjoni nxënësin deri në fund se çfarë ka për të thënë. Në ndërkohë, mund ta pyetni me qëllim që të nxirrni më shumë argumente dhe pretendime nga ana e nxënësit. Thirrni edhe nxënësit e tjerë që të përfshihen në diskutim me ç'rast do t'i çoni në të menduarit kritik dhe analitik. Nxënësit duhet të kuptojnë se shteti ynë është sekular, i garanton liritë dhe të drejtat fetare dhe se askush nuk mund të jetë i detyruar që t'i përshtatë qëndrimet dhe mendimet e tij religjioze me qëndrime të caktuara shkencore.

Rekomandohet që prindërit të përfshihen në dialogjet e tilla nëse e kërkon nevoja. Nëse dialogu është i pasuksesshëm, ndërsa nxënësi sillt në mënyrë injorante dhe refuzon të marrë pjesë në mësim gjatë përmbajtjes tematike, atëherë mbetet të zbatohen masa disiplinore që jenë në përputhje me rregulloren e shkollës.

10

Situata 10: Çfarë duhet të bëj si mësimdhënës nëse nxënësi shpërndan material ekstremist ose fetar propagandistik në shkollë?

Sfida: Mësimdhënësi vëren se ndonjë nxënës ose një grup nxënësish u shpërndajnë material propagandistik nxënësve të tjerë dhe i thërrasin me zë për të bërë veprime të caktuara.

Opsioni për veprim: Nëse materiali propagandistik dhe thirrjet e nxënësve janë jashtëzakonisht të dhunshme dhe thërrasin për veprime të dhunshme për shkak të zbatimit të aksioneve për nevojat e një kauze të caktuar, kjo është një vepër penale dhe atëherë është më se e qartë se për veprime të këtilla duhet menjëherë të përfshihet drejtoria e shkollës dhe të thirret policia. Shpërndarja e materialit propagandistik mund të jetë një lloj rekrutimi i nxënësve, nëse ata që e shpërndajnë materialin janë tashmë persona të radikalizuar. Nxënësit në këtë mënyrë lehtë mund të mashtrohen, për shkak se janë në një moshë në të cilën u interesojnë gjëra të ndryshme, veçanërisht nëse manifestohen në një mënyrë “sensacionale”.

Fakti se në shtetin tonë numri më i madh i luftëtarëve që shkuan në konfliktet luftarake në Siri dhe Irak kanë prejardhje nga lagje të njëjta dhe ishin të lidhur në baza familjare dhe shoqërore, bën që të dyshosh se mënyra e këtillë e rekrutimit të personave të rinj është rrezik dhe mund të ketë pasoja të mëdha për nxënësit nëpër shkolla.

Për të parandaluar dukuritë dhe aktivitetet e këtilla, mësimdhënësi do të mund të hap një diskutim në orë me nxënësit lidhur me ndikimin e propagandës dhe materialit propagandistik, si në kontekstin pozitiv, ashtu edhe në atë negativ. Në këtë mënyrë do t'i inkurajojë dhe do t'i nxisë nxënësit që të diskutojnë, të mendojnë në mënyrë kritike, por edhe të zbulojë se cilët prej nxënësve kanë njohuri të mira për propagandën dhe mënyrën e veprimit të saj.

11

Situata 11: Çfarë duhet të bëj nëse shohë një situatë se jashtë para oborrit të shkollës ka persona të dyshimtë të cilët ndalojnë nxënësit dhe kontaktojnë me ta?

Sfida: Mësimdhënësi në një periudhë të caktuar vëren persona të dyshimtë të cilët lëvizin dhe qëndrojnë në shkollë dhe njëkohësisht realizojnë kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit.

Opsioni për veprim: Së pari duhet t'i pyesni nxënësit nëse dikush i nje personat e jashtëm ose janë të afërm dhe miq të tyre, pastaj konsultoheni me administratën e shkollës, kontaktoni me prindërit e fëmijëve dhe më në fund paraqiteni në polici. Por, para se të merrni një vendim për t'u paraqitur në polici, ndiqni këtë situatë dhe këta nxënës për një periudhë të shkurtër kohe për të parë nëse

kontakti i këtillë vazhdon të realizohet dhe nëse këta persona të dyshimtë vijnë dhe qëndrojnë para oborrit të shkollës. Të rinjtë në këto vite janë shumë të rrezikuar dhe për këto arsye lehtë mund të bien nën ndikimin e grupeve kriminale dhe radikale, të cilat të rinjtë i shohin si potencial të madh për arritjen e qëllimeve të tyre. Përgjegjësia e mësimdhënësve është që të kujdesen për sigurinë e nxënësve të tyre dhe t'i mbrojnë ata nga përpjekjet e këtilla për t'u tërhequr në struktura radikale apo kriminale.

12

Situata 12: Çfarë nëse nxënësi vizaton një simbol etniko-nacionalist, si për shembull pistoletë dhe thikë, ose një nxënës vjen me mbrojtës me skelet në kokë dhe një fotografi me armë dhe thikë, duke përfaqësuar të ashtuquajturat “shoqata etniko-nacionaliste patriotike“, të cilat angazhohen për ideologjinë e krahut të djathtë për “Një shtet të vetëm“. Nëse ballafaqoheni me një situatë të këtillë apo të ngjashme, çfarë do të bënit?

Sfida: Mbajtja e fanellave me vizatime dhe simbole të shtypura është një gjë e zakonshme në mesin e popullatës së re, por vizatimi i simboleve gjatë orës apo në muret e klasës është një sfidë për mësimdhënësin dhe personelin tjetër të shkollës për të mësuar dhe për të identifikuar se çfarë

saktë paraqesin ato fotografi dhe simbole. Shumë herë, të rriturit automatikisht do të supozojmë se nxënësi është nacionalist apo plotë me urrejtje, pa menduar se pse ka ndodhur situata e këtillë. Ndoshta veprimet e këtilla janë të lidhura me periudhën e adoleshencës së nxënësit, ose kjo buron nga ndonjë përjetim traumatik të drejtuar drejt një grupi të caktuar etnik ose racor. Gjithashtu, manifestimet e këtilla mund të shkaktohen nga presioni i kryer nga bashkëmoshatarët. Prandaj, rekomandohet që mësimit të nxënësit të parë të përpiqet të kuptojë më mirë situatën që të mund të krijojë një ide se si të veprojë.

Opsioni për veprim: Në një rast të këtillë, mësimit të nxënësit të parë do të duhej të bisedonte me nxënësin dhe ta pyesë atë se çfarë domethënie ka simboli i fanellës të tij dhe/ose vizatimi që e vizaton, me qëllim që të mësojë më shumë për arsyet e manifestimit të këtillë. Duhet ta dëgjojë me vëmendje nxënësin dhe në ndërkohë t'i parashtojë pyetje

shtesë me qëllim të fillojë diskutim. Rekomandohet që mësimit të nxënësit të zhvillojë një diskutim konstruktiv me të gjithë nxënësit me qëllim që t'i kuptojë qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre lidhur me temën e filluar të bisedës.

Këtu paraqitet dilema nëse këto veprime dhe vizatime paraqesin shenja të një radikalizmi fillestar që do të çonte në dhunë. Mësimit të nxënësit duhet ta ndjekë situatën në klasë dhe të zbulojë nëse edhe nxënës të tjerë fillojnë të manifestojnë dukuri dhe veprime të këtilla dhe të ngjashme që janë karakteristike për një grupacion specifik ideologjik etniko-nacionalist.

Nëse nxënësi me të njëjtat veprime vazhdon të motivojë edhe nxënës të tjerë që t'i bashkohen, atëherë është momenti i vërtetë kur mësimit të nxënësit të bashku me pedagogun duhet t'i thërrasin prindërit për bisedë. Por, nëse edhe pas kësaj nuk zgjidhet situata, ndërmerren masa të tjera të cilat janë në përputhje me rregulloren e shkollës.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.13-053.6:373.5(497.7)(047.31)
364.632-053.6:373.5(497.7)(047.31)

MUSLIU, Afrodita

Doracak për mësimdhënësit në shkollat e mesme dhe vegla për
zbulim të hershëm dhe veprim : parandalimi dhe ballafaqimi me
redikalizimin që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm : identifikim,
parandalo, vepro / autorët Afrodita Musliu, Ivica Simonovski. - Shkup :
Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave, 2019. - 28 str. : ilustr. ; 30 cm

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-4586-57-9

1. Simonovski, Ivica [автор]

а) Насилен екстремизам - Превенција и интервенција - Средни училишта -
Македонија - Прирачници
COBISS.MK-ID 109956106

